



Qendra për Arsim e Kosovës  
Kosova Education Center

Kodi: 041

**KEC**

## **PROGRAMI I ARSIMIT CILËSOR**

*Trajnim për personelin mësimor -edukativ të arsimit para-universitar*

Tipi i Programit: Plotësues

### Historiku i Programit

Fillet e këtij programi gjenden në Lëvizja e Shkollave Efektive- LShE të mesit të viteve të '70 të shekullit të kaluar. Në fokus të kësaj lëvizjeje ka qene matja e efektivitetit të shkollave dhe përkufizimi i saktë i asaj çka është shkollë efektive , përkatësisht është shtruar pyetja cila shkollë mund të quhet shkollë efektive dhe cilësore?

Mbi bazën e kësaj filozofie është hartuar projektit i quajtur “Programi i Arsimit Cilësor”. Ky projekt ka filluar të zbatohet në KEC në vitin 2000 me financim të International Rescue Committee ( IRC) dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Nga viti 2001 deri në fund të vitit 2003 ky program, i freskuar dhe i modifikuar, është financuar nga Save the Children UK. Për të nxjerrë përfundime për efektivitetin e zbatimit të këtij projekti KEC ka zhvilluar dy hulumtime. Në këto hulumtime është konstatuar se në 42 shkollat të cilat kanë qenë të përfshira në projekt ka dallime sinjifikante në fushën e të drejtave të fëmijës dhe në arritjet e nxënësve në lëndët: Gjuhë amtare, Matematikë, Kimi dhe Biologji, krahasuar me shkollat të cilat nuk kanë qenë të përfshira në projekt. Rezultatet e hulumtimit të drejtave të fëmijës janë publikuar në Konferencën Ndërkombëtare të mbajtur në Prishtinë më 30-31 maj 2003, si dhe në librin “Të drejtat e fëmijës në shtë e nxënësve kosovarë”.

Sipas këtij program, në periudhën 2000-2003, janë certifikuar për trajnerë 82 persona, të cilët në shkolla e tyre kanë bërë përhapjen e këtij programi

### Qëllimet e programit:

Pas përfundimit të trajnimit pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të shpjegojnë dhe argumentojnë rolin e shkollimit efikas dhe efektiv në kohën postmoderne,
- Të demonstrojnë aftësi në përcaktimin efektivitetit dhe të efikasiteti të shkollave,
- Të kontribuojnë në shndërrimin e shkollave në organizata të fuqishme të nxënësve
- T'i aftësojnë nxënësit që të mësojnë gjatë gjithë jetës dhe të prodhojnë dije të reja dhe të vlefshme

### Përmbajtja

**1. Karakteristika e shkollës efektive.**– Shkolla – faktori kryesor më i rëndësishëm për zgjidhjen e problemeve në kohën postmoderne. Studimet kryesore për efektivitetin shkollor. Ç'është efektiviteti shkollor? Si matet efektshmëria? Konteksti dhe transferi – bartja e dijeve dhe modeleve nga një vend në vendin tjetër. Karakteristikat e shkollës efektive. Qeverisja - drejtimi profesional. Shkolla efektive ka vizion dhe qëllime të përbashkëta. Çfarë duhet të jetë mjedisi i mësimdhënies dhe i të nxënësve të suksesshëm? Cili është funksioni i pritisëmrive të larta? Ndjekja e përparimit dhe vlerësimi i performancës së shkollës, të mësimdhënësve dhe të nxënësve. Të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve. Mësimdhënia e përqendruar? Mësimdhënia me objektiva. Si të shndërrohen shkollat në organizata të fuqishme të të nxënësve? Partneriteti shkollë- familje - komunitet arsimor.

**2. Zhvillimi i kurrikulit.**– Koncepti i kurrikulit. Llojet e kurrikulave, Lavjerrësi kurrikular; reforma kurrikulare. Metodologjia e iniciimit, hartimit, zbatimit dhe vlerësimit të zbatimit të kurrikulit Vizioni, objektivat, përmbajtjet dhe standardet kurrikulare . Korniza e kurrikulimit. Shtrirja horizontale dhe vertikale e përmbajtjeve. Kërkesat dhe parimet që duhet zbatuar me rastin e përpilimit të përmbajtjeve. Kurrikuli “ushqim” për zhvillimin maksimal të fëmijëve. Metodologjitë dhe strategjitë e mësimdhënies.

**3. Vlerësimi në bazë shkolle.**– Koncepti i vlerësimit, metodat, dhe instrumente e vlerësimit. Llojet e vlerësimit. Institucionalizimi i procesit të vlerësimit

**4. Shkolla dhe komuniteti.**– Shkolla dhe komuniteti nga këndi i Teorisë së përgjithshme të sistemeve Studimet themelore për partneritetin shkollë komunitet. Krijimi i Rrjetit të “Merimangës së partneritetit”. Partnerët e mundshëm. Planifikimi i partneritetit.

**5. Menaxhimi i ndryshimeve në shkollë.**– Koncepti i ndryshimit. Çka mund të jetë objekt ndryshimi në shkollë? Cilat janë agjentët e ndryshimit. Llojet e ndryshimeve. Si mund të realizohet ndryshimi në shkollat e Kosovës

**6. Multikulturalizmi.**– Ç 'është shkolla multikulturore. Etapat e formimit të shkollës multikulturore. Elementet e shkollës multikulturore.

### Grupi i synuar

Ky program u dedikohet edukatoreve të edukimit parashkollor, mësimdhënësve të arsimit para-universitar, drejtorëve në arsimin parauniversitar, bashkëpunëtorëve profesional (pedagogëve, psikologëve, logopedëve, bibliotekarëve dhe mentorëve).

### Metoda e punës për realizimin e programit

Programi për aftësimin i aftësim zgjatë 24 ditë me gjithsej 142 orë. Programi zhvillohet në formë të gjashtë seminareve nga katër ditësh. Ndërmjet dy seminareeve monitorohet puna e pjesëmarrësve. Për monitorime janë hartuar instrumente të caktuar matëse: pyetësorë, teste dhe protokoll vazhdimi. Trajnimet zhvillohen në grupe prej 25-30 pjesëmarrës.

### Vlerësimi/Certifikimi

Certifikimi për bëhet në nivelin:

- a. Pjesëmarrjes
- b. Trajnerit

Kriteret për certifikim për pjesëmarrje është vijimi i më së paku 80% të orëve, mbajtja e dosjes dhe vlerësimi pozitiv nga monitorimet.

Kriteret për certifikimin për trajner janë: vijimi i të gjitha orëve të trajnimit, mbajtja e dosjes, vlerësimi pozitiv nga monitorimi, intervista në të cilën pjesëmarrësit do të tregojnë njohje të thella për Programin e Arsimit Cilësor

### Materialet e trajnimit

1. Hyseni H., Mita N., Salihaj J., Pupovci D.: *Qeverisja dhe udhëheqja në arsim (Si të bëheni udhëheqës i suksesshëm?)*, Modulet:VI;VII;VIII dhe IX, KEC, Prishtinë, 2003.
2. Halim Hyseni, Robert Gjedia, Erlehta Mato, Nikoleta Mita, Avni Dalipi: “Të Drejtat e Fëmijës”. Manual për të Drejtat e Njeriut dhe Fëmijës” KEC, 2004.
3. Hyseni H.: Të drejtat e fëmijës në sytë e nxënësve kosovarë, KEC, 2004.
4. Halim Hyseni, Doracak për edukimin multi/inter/kulturor, KEC, 2010.